



Trajneri durrsak u shpreh i kenaqur me menyren se si ekipi i tij i krijoi presion ekipit kundërshtar. Ai u shpreh se ska rëndësi emri i ekipit kundërshtar sepse lojtarët e tij e sulmojnë atë që në mbrojtjen e tyre. Për më tepër sot lojtarët vrapuan shumë. Djemtë i shërbyen mirë njeri tjetrit edhe i zhvilluan mirë detyrat taktike. Nuk na ndihmoi as fusha që ishte e rënduar nga shiu por ja arritem qëllimit që të ndërprisnim lojën e tyre duke mos lejuar furnizimin me topa për dyshen sulmuese të Teutës. Ndeshja u bë e bukur dhe agonike por në fund nervozizmi kaloi limitet nga të dyja palët, fatkeqësisht ky është limit i futbollit tonë. Djemtë e meritojnë plotësisht pozicionin që kanë në tabelë biles më pak më tepër të kujdes mund të ishin edhe më mirë. Edhe sot në fund patëm një humbje të ekuilibrit që na kushtoi atë gol të pesuar. Vucajt i uroj që të arrijë sa më lart. Unë mendoj se që lojtarit duhet të jepet mundësia e përmirësimit në karrierën e tij. Normalisht që Erjoni është kapiteni jonë dhe një lojtar tepër i rëndësishëm por ekipi nuk bëhet vetëm me një lojtar. Gjithashtu dua të falënderoj Edvan Bakaj që luajti i demtuar. Kishte një terheqje në këmbë dhe gjatë gjithë ndeshjes kishte dhimbje por shterngoi dhembet dhe na ndihmoi sot.